Kronikë

# Sekuestrohet arsenal armësh dhe municione luftarake në Shkodër, dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale! 2 në pranga, 1 në kërkim

*Nga kontrolli i 8 banesave në disa lagje të qytetit të Shkodrës janë gjetur arsenal armësh, mina, tritol, fishekë dhe aparatë për bllokim valësh që dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë.*

Redaksia
31 Tetor, 10:55 | **Përditesimi: 31 Tetor, 14:35**

Nga kontrolli i 8 banesave në disa lagje të qytetit të Shkodrës janë gjetur arsenal armësh, mina, tritol, fishekë dhe aparatë për bllokim valësh që dyshohet se janë përdorur në ngjarje kriminale të ndodhura më parë. Në pranga kanë rënë Petrit Kubazi, 52 vjeç, dhe djali i tij, Gledis Kubazi, 20 vjeç. Gjithashtu do të hetohet në gjendje të lirë Gerlad Kubazi, 16 vjeç.

Gjatë kontrollit të forcave RENEA dhe FNSH Në banesën e tyre u gjetën: 3 mina me telekomandë, të lidhura me telefon, 8 kallëpe tritoli C4, gati për përdorim, me peshë totale 1 kilogramë e 600 gramë, kapsolla detonatore të lidhura me tela, të gatshme për përdorim, 1 armë gjahu (shotgun) me 2 gjerdanë dhe 50 fishekë, 1 radio si ato të Policisë, 1 aparat për bllokimin e valëve, 3 aparate celulare dhe 1 armë sportive.



LEXO EDHE:
**Fotografoi kërkesën për ekstradimin e Ibrahim Licit nga Turqia, pezullohet nga detyra sekretarja e prokurorisë në Shkodër**

Gjithashtu janë zhvilluar kontrolle në banesën e Cuf Mataj, i cili po hetohet në gjendje të lirë për shkak të moshës së madhe ndërsa i biri Ismet Mataj, 45 vjeç, është shpallur në kërkim. Ai nuk ishte në shtëpi kur mbërriti policia.

Forcat blu gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri kallashnikov, 5 krehra me fishekë dhe një sasi tjetër fishekësh kallashnikovi (gjithsej 280 fishekë), 1 armë zjarri pistoletë tip TT, me krehër me 7 fishekë, 20 fishekë luftarakë të kalibrit 7.9 mm, që përdoren për pushkë snajper, 5 krehra pistolete të kalibrit 9 mm me fishekë në të, 1 armë gjahu, 1 radio si ato të Policisë dhe 2 aparate celulare.

Po vijon puna për zbardhjen e qëllimit të prodhimit dhe mbajtjes së minave me telekomandë, të cilat, nga veprimet e para hetimore dyshohet se do të përdoreshin nga një grup kriminal.

A.M./Shqiptarja.com

TAG: Shkoder | Renea | fnsh | Petrit Kubazi | Gledis Kubazi | Ismet Mataj

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**A duhet të shtohet numri i bashkive në vend?**

PO | JO | Nuk kam mendim

## Lajme të tjera



KLSH kallëzon Ministrinë e Kulturës për restaurimet në 'Kafen e madhe' dhe 'Gjuhadol-in' në Shkodër: Ndërhyrjet, pasoja të parikuperueshme

Arsen Rusta

30 Tetor, 15:38



60 role në 4 dekada! I jepet lamtumira Enver Hysenit! Kolegët: Fjala 'i paharruar' është shumë pak për të

30 Tetor, 12:15



I riu në burgun e Shkodrës befason Apelin: Dua të dal se më rrezikohet martesa! Kam gruan shtatzënë e nuk e ndihmon njeri për punët

30 Tetor, 11:23



Ndahet nga jeta aktori i njohur i Teatrit Migjeni në Shkodër! Kapitullin e karrierës së tij artistike e mbylli me personazh vetëveten

29 Tetor, 20:08



Në pranga apo jo? Ibrahim Lici përgënjeshtron lajmet: Jam i lirë në Turqi! S'kam lidhje me vrasjen e Endri Mustafës, jam në kërkim për t'u pyetur (AUDIO)

27 Tetor, 15:09



Shkodër/Ishte në kërkim dhe qëlloi me armë RENEA-n kur shkoi ta arrestonte, në pranga 49-vjeçari! Ka qenë i dënuar më parë për vrasje (EMRI)

27 Tetor, 10:29



Shkodër/ Të shtënat me armë zjarri pas një konflikti të çastit! Autori qëlloi drejt makinës së dy vëllezërve dhe u largua! Ende në kërkim, në pranga David Kiri

26 Tetor, 07:11



Të shtëna me armë zjarri në Shkodër! Një makinë në lëvizje qëllon në drejtim të 'Touareg' të zi të parkuar (VIDEO)

25 Tetor, 22:58



Në kërkim për vrasjen e Endri Mustafës në Shkodër, Ibrahim Lici në Turqi që prej korrikut! Autoritetet turke: Na sillni kërkesën për ekstradim! E paqartë nëse është arrestuar apo jo

25 Tetor, 16:18



Turizmi në Reç, fshatin e gështenjave në Malësi të Madhe! 120 familje të punësuara, investitorët: Kemi hapur bujtina, turistët mbeten të kënaqur

Ergys Kavaja

25 Tetor, 09:22



Në kërkim të kriminelëve, FNSH e Policia kontrolle në Vlorë e Korçë

23 Tetor, 19:57



Java Kulturore e Austrisë, në Shkodër hapet ekspozita që tregojnë lidhjet e vjetra mes qytetit dhe ish perandorisë së madhe evropiane

Ergys Kavaja

22 Tetor, 18:00









© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje